



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr. -060/PB- 45755 dt. 23/10/ 2020

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Labinot Halilaj, më datë: 30/10/2020 (e Premte) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kulturës të Komunës.


THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 23.09.2020.
2. Raporti Financiar i Zhvillimit Të Buxhetit Janar Shtator 2020.
3. Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit 12-400-40369,të datës. 23.09.2020,të Kuvendit të Komunës së Drenasit.
4. Propozim Vendim shfuqizimin e Vendimit 12-400-40360, të dt. 23.09.2020,të Kuvendit të Komunës së Drenasit.
5. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të pronave të paluajtshme (njësive të ndërtesave –banesave) ,në parcelën nr. 743-1,në zonën kadastrave në Drenas (Glllogoc).
6. Propozim Vendim për këmbimin e pronave të paluajtshme (ndjesive të ndërtesave-banesave) në parcelën nr. 743-1,në zonën kadastrave në Drenas (Glllogoc).
7. Propozim Vendim për shpronësimin e pronave të paluajtshme (njësive të ndërtesave –banesave) ,në parcelën nr. 743-1,në zonën kadastrave në Drenas (Glllogoc).
8. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të pronave të paluajtshme të hekurudhave të Kosovës (Shoqëri Aksionare) për parcelat nr. 953-1,961-0,956-0, të cilat ndodhen në zonën kadastrale Drenas (Glllogoc).
9. Propozim Vendim për transfero të mjeteve nga projekti rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbëruese dhe rregullimi i sheshit të qytetit në projektin mirëmbajtja e kanalizimeve fekale, atmosferike dhe gropave septike.
10. Propozim Vendim për shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të pronave të paluajtshme ish shoqërore të OP-Drenicës,të cilat janë nënë menaxhimin e AKP-së, në zonën Kadastrale Korroticë të Epërme.
11. Të ndryshme.

Drenas, 23.09.2020



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Labinot Halilaj



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



12 Nr. 069/04-44533 dt. 16/10/ 2020

Mbledhja e rregullt

23.09.2020

Kuvendi Komunal

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të mbajtur më datë: **23.09.2020**

Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 30, anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 31.08.2020.
2. Propozim Vendim për këmbimin e njësive të ndërtesave (banesave) në zonën Kadastrale në Gllogoc.
3. Propozim Vendim për shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të pronave të paluajtshme (njësive të ndërtesave-Banesat), në parcelën nr. 743-1, në zonën Kadastrale në Drenas.
4. Propozim Vendim për shfuqizimin e vendimit për definimin dhe parcelizimin e të gjitha varrezave të cilat ndodhën në prona komunale në Komunën e Drenasit.
5. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit, për vendosjen e Bustit të Heroit të Kombit Fetah Kiqina.
6. Propozim Vendim i Buxhetit të Komunës për vitin 2021 dhe parashikimi i Buxhetit për vitet 2022-2023.
7. Raporti i zyrës Kombëtare të Auditimit.
8. Plani i implementimit të rekomandimeve të zyrës Kombëtare të Auditimit
9. Raporti i proformancës Komunale për vitin 2019.
10. Raporti periodik i zbatimit të rekomandimeve të ZKA
11. Propozim Vendim për transferin e rezervës buxhetore
12. Raportimi për ecurin e procesit mësimor nga DKA
13. Të ndryshme.

Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të datës 23 /09/ 2020 ishin:Kryetari Ramiz Lladrovci, Shefi i Kabinetit të Kryetarit Flamur Curri, kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj, këshilltarët e KK, zyra e informimit si dhe drejtorët e Drejtorive përkatëse , monitoruese nga handekosi Arbenita Haziraj.

Kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj -pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit besoi se te gjithë jeni të informuar me pikat e e rendit të ditës të kësaj seance a ka dikush diçka fjalën e merr Drejtori i Financave Shyqiri Bublaku.

Drejtori i Financave Shyqiri Bublaku- përshëndetje për të gjithë kisha kërkuar që në rënd të ditës të shtohen edhe dy pika ku e kemi: Raporti periodik i zbatimit të rekomandimeve të ZKA. Propozim Vendim për transferin e rezervës buxhetore

Kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj -besoi që u njoftuat me pikat shtesë a ka dikush diçka fjalën e merr.

Sokol Bylykbashi –përshëndetje për të gjithë fillimisht dua të bëj një kritik sa i përket kësaj mbledhje ta quaj buxhetore ku kemi prape buxhet ,në një seance të caktuar nuk është mirë me pas pika tjera ,sepse ngarkohet shumë ka mundur të jetë eventualisht edhe procesverbali edhe propozimi për transfere, në fakt fjalën e morra për një kërkesë që të futet edhe një pikë shtesë sepse kemi nevojë të njoftohemi për ecurinë e arsimit në komunën tonë. Raportimi për ecurinë e procesit mësimor nga DKA.

Kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj- hodhi në votim pikat e rendit të ditës me pikat shtesë si dhe pikën e . Raportimi për ecurinë e procesit mësimor nga DKA ,njëkohësisht edhe pika e 6 te shqyrtohet si pikë e dytë ,kurse pika e dytë zhvendoset në pikën e gjashtë .Ky rend ditë votohet në mënyrë unanime

Kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj -hapi për diskutim 1.Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 31.08.2020.Diskutime nuk pati edhe kjo pikë u votua në mënyrë unanime.

Kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj -hapi për diskutim2. Propozim Vendim i Buxhetit të Komunës për vitin 2021 dhe parashikimi i Buxhetit për vitet 2022-2023.

Drejtori i Financave Shyqiri Bublaku-me qarkoren e tret buxhetore e cila ka ardhur me datën 15.09.2020 kemi shkurtim të buxhetit për vitin 2021 nga granti qeveritar me shumën e buxhetit 243,609,00 €, edhe të hyrave vet anakë për 84.130.00€, që kjo ka reflektuar edhe në buxhetin e përgjithshëm të Komunës së Drenasit për vitin 2021-2023 sa i përket propozim vendimit për buxhetin .Buxheti për 2021 është me vlerë prej, 15.399,334, sektori i përgjithshëm për vitin 2021, është 6.842.147, për vitin 2022 është 7.227.607 € për vitin 2023 7.583.397 € në sektorin e arsimit për viti 2021 6.472.573, viti 2022 7.039.890 € dhe për vitin 2023 7.070.544 sektorin e shëndetësisë për vitin 2021 2.084.614€. , për vitin 2022 2.939.945 dhe për vitin 2023 2.956.474€ këto janë buxhete që janë nda për vitin 2021 shuma prej 15.399.334 për vitin 2022 17.207.442 për vitin 2023 17.610.415 ,sa i përket investimeve kapitale kemi pasur buxhetin 4.436.ndërsa tani është zvogëluar shuma 243.000 € dhe kemi buxhetin për investime kapitale prej 4.108.446 € këto kishin me qenë njoftimet rreth buxhetit ,nëse ka dikush me pyete diçka. Të bashkangjitur e kemi edhe listën e projekteve te investimeve kapitale për të gjitha drejtorit dhe kategoritë e shpenzimeve.

Vehbi Berisha – edhe me herët e kam ngrit çështjen e njëjte ,dhe prape po e ngriti shqetësimin për listën e projekteve kapitale ne ju kemi mirë kuptuar si kuvendë e di që ka bukur gjatë

procedura të prokurimit dhe keni thënë që mundni me i fute, disa fshatra me një kod kur keni të bëni me procedurat e asfaltimit por keni thënë që kur të behët miratimi buxhetit të na sillen lista neve si anëtar të kuvendit që mos të marrim vendime pa bazë p.sh asfaltimi i rrugës në fshatin Sankoc , Fushtic e Epërme dhe e Ulët as nuk e di për cilën rrugë behët fjale, as nuk e di sa metra kanë me shkuar në Fushtic as në Sankoc njëjte e ki edhe për kanalizim edhe për projekte tjera pasi jemi Komuna me transparente të bëhemi transparent pak edhe me vetë veten, sepse unë personalisht po votoj diçka veq po ta mundësoi sa për me kalua ti një dokumente dhe pastaj ti me ja kalua drejtorit të Urbanizmit ose drejtorisë përkatëse, mjafton për neve vetëm si material plotësues dhe ndihmës për me ditë ku po shkojnë saktësisht në cilën rrugë.

Drejtori i Financave Shyqiri Bublaku-ju të gjithë e di qe kemi pas shpallen publike për dëgjimet buxhetore kemi kërkuar edhe prej asamblistëve edhe prej qytetareve edhe prej grupeve të interesit dhe biznesmenëve që te marrin pjesë në hartimin e propozim buxhetit për vitin 2021- dhe projeksonimin e buxhetit për vitin 2021-2023,dhe në ato takime nuk kemi pas asamblistë nuk e di ndoshta ka pas, dhe kishte qenë mire që herëve të tjera te merrni pjesë, ne kemi marre kërkesat e qytetarëve nga të gjitha bashkësitë lokale unë e mirëkuptoi Vehbiun mirëpo nuk ka mbete asnjë fshat pa u përfshi në asnjë projekt as ne asfaltime as në kanalizime.

Petrit Sinani - përshëndetje për të gjithë besoi që nuk është ne detyrën e drejtorit me vlerësua a marrin pjesë asamblistët në ndërtimet buxhetore, ne e dimë që edhe ftesën kur e keni bërë e keni bërë vetëm për administratoret e fshatrave mirëpo kjo nuk do të thotë qe nuk kemi pas të drejt mos me marr pjesë ,mendoj që Vehbiu kërkoj diçka që është shumë normale, dhe përgjigjja nuk është ne domenin e drejtorit te financave por te drejtorit tjetër faleminderit.

Sokol Bylykbashi- siç e dimë kjo mbledhje është me e rëndësishmja sepse është draft buxheti komunal me këtë buxhet përfundon periudha katër vjeçare e një qeverisje, të flasim për përfundimin e kësaj periudhë ,të flasim për premtimet e bëra për një mandat, draft-buxheti i fundit është matësi ,një matës i fundit sa i përket realizimit të premtimeve që i ka bërë Kryetari ne fushatën zgjedhore unë kam kërkuar edhe projektet për bashkë financim dhe projektet tjera sa i përket kodeve është dashur që ti ndani kodet buxhetore por prape si keni ndarë nëse, jo për shkak të procedurave të prokurimit se unë jam për me ia lehtësua atyre edhe me u kthye projekti dhe procedurat me letra me u përfunduar me shpejt mirëpo po besoi që kishit mund me gjete një mënyre sepse ju gabimet po i përsëritni, po i kthehemi premtimeve kryetar që i ke dhënë dhe siç po shihet tani janë të pa realizueshme nëse doni ti përmendi., siç është ngrohja e qytetit nga Feronikelit listat e investimeve kapitale mund te shohë vetëm termin asfalt, me vjen mirë qe ka kanalizim me shumë ,mirëpo tek ujësjellësi po mendoj se ajo shumë e cekur 250.000 është pak për me i mbulua problemet me ujë që kanë fshatrat e komunës se Drenasit

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci –ju lutem merruni me pikat e rendit të ditës ,dhe jo me premtime.

Sabrije Kukaj-me sa e pash unë tek projektet ,nuk pash askund buxhet të ndarë për këtë pjesën e lumit sepse më të vërtet ajo pjesë ka mbete shumë keq ,po e shoh që janë gogja do mjete të ndamë për kolektor, nëse nuk mund të rregulloni shtratin e lumit mundeni me këtë buxhet me gjete një zgjidhje për ujërat e zeza ,sepse po dalin mbi lum dhe është një kundërmim i madh si pasojë e këtyre ujërave, unë po mendoj që është koha e fundit me ndërmarrë diçka në këtë pikë ju faleminderit.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- shqetësimi i juaj është shumë me vend po lumi është projekt i ministrisë së ambientit dhe kemi qenë në takim me ministrin dhe kemi bisedua rreth shumë projekteve ,shtrati i lumit nuk është rregulluar për shume arsye siç është ajo e shpronësimit ,kolektorët që i ka ndërtua ministria deri aty po derdhen në lum, unë grandët e fituara po i vendosim kolektorët përgjatë shtratit të lumit si dhe përroskave tjera dhe po investojmë në largimin e ujërave të zeza si dhe shumë projekte të tjera ju faleminderit.

Petrit Sinani –unë kisha propozuar që me këtë buxhet që vjen ti kthejmë sytë kah qendra e qytetit konkretisht në Drenasin I dhe të fillojmë të investojmë me shumë edhe pse normalisht po investohet çdo ditë në projekte të ndryshme ,unë e pash një projekt të shërbimet publike me vlere prej 90.000€ në vitin 2022 për rregullimin e sistemit të ujitjes për shesh dhe kisha pas dëshirë që ky projekt të filloi qysh në vitin e ardhshëm sepse ne kemi dëshirë që Drenasi me fillu me ndryshuar pamjen e vet sa i përket buxhetit në përgjithësi është organizuar mirëpo ashtu edhe te drejtoria për planifikim urban kisha propozua që tek kodi 620 që tregon nivelin e ndotjes në lokacione të ndryshme të fillohet edhe te mendohet edhe për atë projekt gjithashtu ju faleminderit.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci -ke të drejt Petrit se nuk kemi investua mjaftueshëm në qendër të qytetit prandaj i kemi dy pika te rendit të ditës që po kërkojmë me i liru banesat e para 70 vjet ,për me i rrezua për me ndërtu ndërtesa të larta sepse ju jeni anku të gjithë se në Drenas nuk po ndërtohen , rrugën katër korsi jemi duke e bërë prej komunës e deri të hekurudha me kanalizim të ujërave të zeza të ujërave atmosferike me gypa të nxehjeve qendrore, elektrifikimin në tërë komunën jemi duke e bërë.

Petrit Sinani –nuk jemi ankua që nuk po ndërtohet në komunën e Drenasit paske marr informate të gabuar ,se besoj që edhe ti ke dëshirë me pa Drenasin edhe me të ndërtuar edhe me të mirë ashtu mendoj unë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci -unë prita që të na falënderoni që jemi shpall kampion për performancën me të mirë me shërbimet ndaj qytetarit kush do që mendon ndryshe është axhami .

Petrit Gashi- sa i përket ndërtimit të kemi tregu në ditë e para që ke me fillua çdo kund me ndërtua në Drenas se të vyen me ndërtua po nuk ka problem ajo punë deshta një sqarim këtu tek bashkë financimi i projekteve me donatorë të jashtëm a janë të përfshirë p.sh a janë të përfshirë liqeni i Verbocit ,Parku industrial dhe disa projekte tjera te mëdha ja edhe pasi e keni bërë një punë të mirë për çka edhe ju përgëzoj sa i përket kanalizimit te ujërave të zeza në Llapushnik e pashë qe është një shumë e vogël për vitin e ardhshëm dhe nuk do të mjaftonte as me i lidh gypat në gypin qendror unë mendoj që 10.000€ janë tepër pak sa i përket kanalizimit për me kaluar në gypin qendrorë edhe tek pjesa e asfaltimit pra një buxhet prej 50.000€ mendoj që nuk i përmbush as për se afërmi kërkesat të cilat janë në atë pjese, kisha kërkuar një fare balancimi te infrastrukturës në përgjithësi nëpër fshatra si Llapushnik ,Poterk ,Vukofc që është një hapësirë bukur e gjere dhe ka kërkesa shumë të mëdha ja, urime edhe një here që jemi shpall si komuna kampion në performancë por kjo nuk do të thotë që ne nuk duhet me punu ,dhe se opozita duhet me ndejt pasive dhe mos me kritiku qeverinë sepse ,Drenasi është i joni nuk ka rëndësi kush është kryetar e rëndësishëm është projektet me mbet në Drenas faleminderit .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-faleminderit për urimet sa i përket projekteve për bashkëfinancim nuk është as projekti i Verbocit , as Parku i Biznesit ,por janë për projekte që në

ndërkohë me ministri se na duhet me pas një buxhet për me mund me marr buxhet prej nivelit qendrorë kur është puna për bashkëfinancim , sa i përket Llapushnikut i kemi përfunduar të gjitha duke e falënderua Endritin dhe gjithë ekipin e përgëzoi për punën e bërë ,si kryetar i kam kërku nga niveli qendrorë për me përkrah për projekte të rëndësishme për Komunën tonë.

Beqir Kiqina – përshëndetje për të gjithë sa i përket pikës së 6 që është pika me e rëndësishëm në këtë aspekt në nëse do të ishim kundër një buxheti në këtë periudhë të pandemisë e cila e ka godit vendin nuk do te rezultonte mirë mirëpo e pash së Drejtoria për Zhvillim Ekonomik e cila është promotori kryesor për zhvillimin ekonomik të vendit nuk është përfshi nga hartuesit e buxhetit, dhe unë nuk e di pse nuk e ka planifikua komuna e Drenasit sa i përket zhvillimit ekonomik me ndarë mjete te veçanta Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, pse ne me votua një buxhet ku nuk e parasheh me i ndihmuar bizneset të cilat janë duke monitorua në kushte shumë të vështira dhe pandemia i ka rëndu edhe me shumë faleminderit .

Sabrije Kukaj – e kam fjalën për Drejtorin e Arsimit mua po me brengos rrethoja e shkollës në Rasim Kiqina , ndoshta kish pas mundësi me ndarë edhe një pjesë buxhet për arsye se është e pa mundur në pushimin e gjatë me i ndal nxënëset mos me shkuar nëpër marketë edhe po bëjnë gjera të pa hijshme dhe janë të rrezikuar në komunikacion.

Kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj - hodhi në votim pikën e 2. Propozim Vendim i Buxhetit të Komunës për vitin 2021 dhe parashikimi i Buxhetit për vitet 2022-2023.

Për votuan 23

Kundër 2

Abstenim 3

Kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj -hapi për diskutim 3. Propozim Vendim për këmbimin e njërive të ndërtesave (banesave) në zonën Kadastrale në Glllogoc.

Fjalën e merr **Drejtori për Gjeodezi Pronë dhe Kadaster-Ruzhdi Lestrani - përshëndetje** për të gjithë. Propozim Vendimi për këmbimin e njërive të ndërtesave (banesave) në zonën Kadastrale në Glllogoc konkretisht në zonën 743/1 qëllimi për këmbimin e këtyre objekteve banesore është bërë për realizimin e interesave të përgjithshëm publik ne Komunën e Drenasit për projektin e planit urbanistik hapësinor dhe zhvillimor komunal janë gjithsej dhjetë banesa që duhet të këmbehen.

Vehbi Berisha – Desha të pyes për një hartë që ishte ne fund te propozim-vendimit , ishte edhe te kjo pjesa ne fund ku i ka ndërtuar Idrizi ,a kanë me u këmbyer edhe diçka.

Fjalën e merr **Drejtori për Gjeodezi Pronë dhe Kadaster-Ruzhdi Lestrani-** Vetëm rruga i ndanë aty e njejta parcel është.

Kryetari i Komunes Ramiz Lladrovci- Krejt pronat që janë në atë pjesë kanë me u liruar nuk ka rëndësi sa metra edhe sa kateshe janë.

Sabrije Kukaj- Me ne fund, po hiqen ato ndërtesa do me te mëdha do me te vogla rëndësi ka që vetëm qyteti me u doke mire ndoshta marrim ndonjë vendim për diçka te mire aty.

Kryetari i Komunes se Drenasit Ramiz Lladrovci – jo vetëm ato qe janë duke u larguar por edhe çdo objekt i cili vjen ne kundërshtim me planin zhvillimorë me harta zonale me pamje siç jane objektet para stacionit te trenit ose para komunës na kemi me i largu.

Kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj- hodhi në votim pikën 3. Propozim Vendim për këmbimin e njërive të ndërtesave (banesave) në zonën Kadastrale në Glllogoc.

Për votuan 22 ,Kundër 2 , Abstenim 4

Kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj-hapi për diskutim pikën e 4 Propozim
Vendim për shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të pronave të paluajtshme (njësive të ndërtesave-Banesat), në parcelën nr. 743-1, në zonën Kadastrale në Drenas.

Sokol Bylykbashi – sa i përket parcelës me nr.743-1 un nuk e di se qysh e konceptoni ju interesin e përgjithshëm , unë mendoj që nuk është interes i përgjithshëm ne toke te Komunës vete Komuna me bërë, diçka ndërtime të larta dhe kjo mund ti shkoje për shtati vetëm ndonjë ndërtuesi që merret me ndërtime të larta ,nuk ka të bëjë kjo me qytetar dhe interesin e tyre e kam thënë edhe me herët kur kemi të bëjmë me parcela që janë në bërthamë te Drenasit duhet të kemi shumë kujdes.ne nuk duhet me lejuar që parcelat më te mirat të pa zëvendësueshme dhe të pa kthyeshme të shkojnë në favor të grupeve që po na betonojnë Komunën e Drenasit ,interes i përgjithshme është ku qytetaret kërkojnë banesa dhe nuk ka banesa, unë ende se kam dëgjuar ndonjë qytetar që thotë i kam parat e nuk po gjej banes në Drenas .Ky propozim vendim për mendimin tim nuk duhet të kaloj tani ,me qëllimin që të behën ndërtesa te larta .kjo parcelë duhet te trajtohet në mënyrë shumë të kujdesshme edhe me dëgjime publike edhe me përfaqesues te fushave përkatëse dhe në fund të merret një vendim që edhe pas 30 vite nuk pendohesh që e kam marr, dhe i cili e prek në thelb interesin e qytetarit.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-ky kuvend e ka votua planin zhvillimor, urbanistik dhe në atë plan urbanistik dhe zhvillimor është para pa ndërtimi i lart ,dëshira ime kishte qenë me lejuar me u ndërtua ndërtesa 25 katshe sepse është interes i përgjithshëm i Komunës dhe qytetarëve te Drenasit po ata nuk kanë lejuar ligji ,çdo pronë e komunës që është e uzurpuar kane qenë ne shërbim të qytetarëve .

Sokol Bylykbashi-sa i përket të ndërtimeve larta mendoi që komuna duhet me ndikua drejtpërdrejt tek ndërtimet e larta vetëm në një rast , ai rast duhet me qenë ndërtesa kolektive në asistencë sociale vetëm kjo kaq faleminderit

Adem Bucolli- desha me falënderoi së pari zyrën e kryetarit edhe kryetarin për propozim vendimin që na ka sjell sepse me të vërtet ajo pjesë ka mbet në një gjendje shumë të keqe dhe çfarëdo që vendoset me u bërë ka me u bërë me mirë se si është tani që është .Është vërtet që duhet të kemi kujdes se çfarë jemi duke bërë, por prape jemi ne ata që kemi me vendos se çfarë kemi me bërë aty ,rendi i parë është të shpallet interes i përgjithshëm të kompensohen shfrytëzuesve aktual me metër katror dhe pastaj të vazhdojmë me procedurat tjera ju faleminderit.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-në projekt e kemi me i bërë 1000-1500 parkingje rreth Stadiumi Rexhep Rexhepi që i ka jep një pamje shumë të bukur infrastruktura e stadiumit në Poklek te Ri pronat ku janë të Komunës që i kanë uzurpua disa familje .Ideja ime është që krejt parkun me e bërë parking nëntokësor ,sigurisht që edhe sheshin duhet me rregulluar dhe me kohen çdo gjë do të rregullohet .

Adem Bucolli -desha të bëj edhe një pyetje dhe në zgjidhej rreth lokaleve te reja që po ju thonë sepse kanë mbete në gjendje të mjerueshme komplet kati i dytë nuk shfrytëzohet edhe një pjesë në kat të parë edhe aty me mëndu me bërë diçka ose me koncesion edhe unë mendoi ashtu.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci -unë kam kërkuar që atë pjesë edhe stacionin e autobusëve edhe pronën e hekurudhës me marr me bërë bashke si nëpër vendet tjera si në Lubljan ,Zagreb e shumë vende te tjera të zhvilluara.

Florentina Elezi-unë qëndrimin tim e kam jep edhe ne K.P.F-ca dhe kam qenë kundër këtij vendimi për arsye se vetëm keni thënë që është interes i përgjithshëm dhe pa asnjë arsye që duhet unë me votua për, kam kërkuar me ma jep një sqarim se çka konkretisht ka me qenë interesi i përgjithshëm për qytetaret e Drenasit ,unë kisha thënë me qenë në koordinim ti me stafin tende kryetar edhe mos me dal qesharak mos me dit se për çfarë behet fjalë në pikat e rendit të ditës. Po ashtu mendoj që ndërtesat e larat nuk janë kurrfarë interesi i përgjithshëm , ose është dashtë të thuhet së është ne të mirë të zhvillimit ekonomik se është me e logjikshme për trurin unë jam këtu me përfaqësuar interesin e qytetareve të Drenasit ,dhe arsyeja pse njerëzit po ikin nga Drenasi është se jeta sociale është shumë e varfër, ju duhet me rregulluar transportin sepse është zero edhe disa herë e kam ngrit këtë çështje po ashtu nuk ke teatro as kinema nuk ke asgjë që e ngjall qytetin dhe me mirë kish të qenë që për interes të përgjithshëm të bëni diçka që e ngjall jetën në komunën tonë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- saktësisht çfarë ka thënë nënkryetari ashtu është , sepse propozim vendimi ska qenë se çfarë ka me u ndërtuar .

Florentina Elezi-se çfarë bëjnë qytetarët më pronat e veta private nuk na intereson as ty as mua, sepse është e drejt e tyre ndërsa këtu jemi ne asamble për te përfaqësuar qytetarin te cilët paguajnë taksa te cilët na kane votuar për me i përfaqësuar mendimin tim nuk mundet me ndalë as ti as nënkryetari që po mundohesh me mbrojt ,unë e kam fjalën për pronën publike jo atë private dhe sa i përket se a mund me i bind koleget unë nuk mund me i bind sepse unë nuk kam pushtet ashtu siç the ti ata janë shumicë unë pakicë faleminderit

Kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj - hodhi në votim pikën e 4 Propozim Vendim për shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të pronave të paluajtshme (njësive të ndërtesave-Banesat), në parcelën nr. 743-1, në zonën Kadastrale në Drenas.

Për votuan 20 ,Kundër 2 ,Abstenim 6

Kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj-hapi për diskutim pikën 5.Propozim Vendim për shfuqizimin e vendimit për definimin dhe parcelizimin e të gjitha varrezave të cilat ndodhën në prona komunale në Komunën e Drenasit.

Fjalën e merr **Drejtori për Gjeodezi Pronë dhe Kadaster Ruzhdi Lestrani** – Kuvendi i Komunes se Drenasit sipas vendimit me numër 12/252/05/128/772 te datës 30-07-2020 ka nxjerre vendim që të behet definimi dhe parcelizimi te gjitha parcelave ne te gjitha zonat kadastrale ne Komunën Drenasit te cilat ndodhen ne pronat publike por MPL- me vendimin për ligjshmëri Nr.VI-020-545/13 të datës 19.08.2019, ka vlerësuar se akti i komunës së Glllogocit duhet të jetë i harmonizuar me dispozitat e legjislacionit në fuqi, konkretisht me Ligjin nr.04/L-174, Për Planifikim Hapësinor, si dhe Udhëzimit Administrativ 24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës. Deri në një vendim tjetër të harmonizuar, Kuvendi i Komunës së Drenasit shfuqizon vendimin e lartë cekur deri në hyrje të vendimit të hartës zonale të Komunës

Kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj-hodhi ne votim pikën 5.Propozim Vendim për shfuqizimin e vendimit për definimin dhe parcelizimin e të gjitha varrezave të cilat ndodhën në prona komunale në Komunën e Drenasit.Kjo pikë u votua në mënyre unanime.

Kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj-hodhi ne votim pikën 6. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit, për vendosjen e Bustit të Heroit të Kombit Fetah Kiqina. Kjo pikë votohet në mënyrë unanime.

Kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj-hapi për diskutim pikën 7 Raporti i zyrës Kombëtare të Auditimit.

Fjalën e merr Drejtori i financave Shyqiri Byblaku – kisha me ju njoftu sa i përket zyrës kombëtare të auditimit të gjithë keni qenë të pajisur me material d.m.th Zyra Kombëtare të Auditimit ku e ka bërë auditimin e pasqyrave vjetore financiare për vitin 2019 thotë sipas opinionit tonë pasqyrat vjetore financiare për vitin e përfunduar 31 dhjetor prezantojnë një pamje të drejte dhe të vërtet në të gjitha aspektet materiale d.m.th në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik të kontabilitetit ,dihet se buxhetet e kuvendeve komunale

Sokol Bylykbashi – raporti i auditimit për vitin e kaluar përmban te gjetura shkelje pa rregullsi ,mund të përmendi 23 kontrata punë që janë lidhë dhe nuk kanë pasur ndonjë plan ne atë projekt vetëm ka pesë paralogaritje dhe para-masa, kjo është shkelje gogja numër i madh i projekteve, sa përket ndërtimit te kolektorëve d.m.th. vetëm 3 dite pasi qe u lidh kontrata Komuna ka paguar 47% te vlerës se kontratës që është një shkelje, pra dihet shumë me mire se unë kur paguhet një operator që bën një punë te caktuar ,sa i përket rekomandimeve ne një mbledhje te Kuvendit Komunal kemi miratuar një plan te zbatimit te rekomandimeve dhe unë pata vlerësuar shumë atë plan, mirëpo ky raport tash po na thotë qe nuk jemi mire sa i përket zbatimeve thuhet qe vetëm 5 te kenë rekomandime qe janë fatura ,Komuna, një ne proces tri te mbyllura d.m.th. numër shumë i vogël i patundshmërisë ndërsa një raport qe ka bërë këtu ne komision ka paraqitur një pasqyre krejt tjetër ,aty thuhet se është një numër shumë me i larte i rekomandimeve te zbatuara ,është mirë që këto të gjetura me i zbatuar është mirë që punëtoret me ta tregu ty gjendjen reale se pastaj del dikush tjetër që ta tregojn gjendjen reale .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- së pari i falënderoi të gjithë zyrtaret dhe falënderojë për raportin e jashtëzakonshëm, mirë te vlerësimit te Zyrës Kombëtare te Auditimit qe ka bere për Komunën e Drenasit .Rekomandimet qe i jep Zyra e Auditorit kur ka shkelje e ka obligim me i dërguar në prokurori, kush do që e ka shkele ligjin përgjigjet para gjyqit, ndërsa koston politike e mbaron në qofte se është tu shkele ligj, rekomandimet qe i përmende ti pagesat 50/60% e kolektorëve pas tre dite qe e ka lidh kontratën Komuna është e ligjshme është e drejte dhe Komuna ka te drejte me pagu ,dhe ka pagu situacionet për te cilat ka dhënë sqarime. Auditori jep rekomandime edhe për pagesat përmes përmbaruesit ose përmes gjyqit qe na vjen si rezultat i ,marrëveshjeve të ministrave te ndryshëm, marrëveshjeve kolektive për arsim dhe asnjëherë nuk i ka bërë vërejtje atyre qe kanë lidhur ato marrëveshje kolektive qe janë me kundërshtim me ligjin sepse pa parashikim te buxhetit askush nuk mund të lidhet për njëjtën marrëveshje dhe unë ketë problem e kam ngritur ne Asociacionin e Komunave dhe besoj që ka filluar procedurat e një denoncim në hetuesi ,prokurori të atyre që kanë lidhe kontrata të kundërligjshme. Në qoftese dikush thotë që ka pas korrupsion në ato pagesa me thoni dhe i shkojmë bashke deri në fund me procedura hetimore gjygesore, por nëse ka pas ndonjë gabim zyrtaret tanë do te mundohen që te mos i përsëritin .

Vehbi Berisha –unë desha të diskutoi në lidhje me rekomandimin e auditorit të përgjithshëm që po na përsërit rreth pagesave të pagave jubilarë marrëveshjet që dalin nga këto kontratat kolektive a keni provua të bëni ndonjë zgjidhje sepse afër 200.000€ po shkojnë te përmbaruesi, ne kishim mund me këtë shumë me bërë shumë punë tjera .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-për paga jubilarë ne e kemi gjet një marrëveshje, kryetaret e komunave me ministrin dhe i kemi para parë në buxhet po ne i kemi shumë vite për para të cilët i kanë dërgua nëpër gjykata, unë kam dëshirë me ja paguar shujtën shumë mësime dhe shumë tjerëve por kur nuk me lejon ligji nuk para shikoj buxhet kur nuk mund me realizuar.

Kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj-hapi për diskutim pikën 8.Plani i implementimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Faljen e merr **Drejtori i Financave Shyqiri Bubaku** materialin e keni të gjithë këtu janë hapat që i kanë parapare që do të ndërmerren për implementimin Zyrës Kombëtare të Auditimit si e keni par edhe në raport në plan është vendimet për pagat jubilarë dhe tri pagat përcjellëse ai shqetësim është përfshi në vitin 2021 për vitin 2020 do të vazhdoj njëjete me gjithë se kemi shpenzime me të vogla në këtë vite në këtë kategori , një njoftim një pagë jubilarë nëse i paguhet dikujt neve na numërohet keq planifikim, keq menaxhim ,keq shpenzim d.m.th një element jep tri rekomandime të keni parasysh edhe këtë sepse kanë aprovuar kontrata kolektive pa mase buxhetore që me ligj nuk lejohet dhe ne si komunë mbesim para aktit te kryer

Kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj-hodhi ne votim pikën 8.Plani i implementimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Kjo pikë e rëndit të ditës u votua në mënyrë unanime.

Kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj-hapi për diskutim pikën 9.Raporti i performancës Komunale për vitin 2019.

Kryetari i Komunes Ramiz Lladrovci- unë nuk kisha fol gjatë sa i përket Raporti i performancës Komunale për vitin 2019, sepse që disa vite rresht kemi zënë vendi e dyte ,tret edhe si vjet vendin e pare pa llogarit edhe ato që nuk kanë vlerë pagese dëshiroi ti falënderoi të gjithë zyrtarët e komunës ,ekzekutivin për punën që kanë bërë edhe juve asamblistët komisionin që e ka udhëheq Afrim Prokshi të cilin e falënderoi publikisht për punën që ka bërë.

Kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj-hapi për diskutim pikën 10.Raporti periodik i zbatimit të rekomandimeve të ZKA

Kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj diskutime nuk ka vazhdojmë të pika e radhës .

Kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj-hapi për diskutim pikën 11.Propozim Vendim për transferin e rezervës buxhetore

Fjalën e merr **Drejtori i Financave Shyqiri Bubaku**- rezerva buxhetore ka qenë pjesë e buxhetit të para pare për paga mirëpo për shkak të anulimit të listës se pagave kjo ka kaluar si rezerve buxhetore jemi mundu që këtë rezerve buxhetore ta shfrytëzojmë investimet kapitale ku kemi me se shumti nevojë nëpër sektorë të ndryshëm .

Diskutime nuk pati **Kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj** hodhi ne votim pikën 11.Propozim Vendim për transferin e rezervës buxhetore.

Për votuan 26 ,Kundër 0 , Abstenim 2

Kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj-hapi për diskutim pikën 12.Raportimi për ecurinë e procesit mësimor nga DKA.

Fjalën e merr Drejtori i Drejtorisë se Arsimit Muhamet Gjoka –përshëndetje për te gjithë Komuna e Drenasit ka bërë të gjitha përgatitjes që mësimi të filloi me një shtator bashke me inspektorët kemi vizituar te gjitha shkollat mirëpo vendimi ka qenë i ministri që mësimi të filloi me 14 shtator nga ministria kemi marr konstatimin me raporte se përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor te gjitha shkollat në Komunën e Drenasit kanë qene ne nivelin e duhur ,dhe jemi duke ju përmbajt në detaje protokolleve të parapara të gjitha shkollat janë pajise me dezinfektues ,maska dhe te gjitha mjetet tjera higjienikë në mënyrë që të ju përmbahemi protokolleve të cilat janë shumë stërkite. Ne si DKA marrim raporte nga drejtoret në baza ditore sa i përket procesit mësimor dhe deri me tani gjithçka ka shkuar sipas planifikimit dhe nuk është raportuar asnjë problem gjatë kësaj periudhë .

Kimete Bardhi-përshëndetje për te gjithë ajo çfarë tha drejtori edhe qëndron fatmirësisht vetëm e kam një këshill sa i përket dezinfektuesve që është anti bakterial ,unë kisha propozuar që përbërja me qenë me tepër me alkool kjo është .

Sokol Bylukbashi –faleminderit për raportin drejtor po të thoshe që drejtorja që unë e udhëhoqi ka bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e vit të ri shkollor ndoshta isha pajtua po mos thuaj komuna se procesi mësimor prek edhe segmente të tjera desha të flas për një problem qe kanë nxënësit që po pres rreth dy orë, ata nxënës shumica prej tyre kanë mujore për shkak të çmimit me të lire se ne e dimë që ka edhe kombi ,ata mund të shkojnë edhe me kombi edhe mos me prit hiq pra ky është një problem jo i vogël në këtë rast drejtorja përkatëse duhet me fol me ato kompani për me pas linja të rregullta në kohen kur nxënësit lirohen.

Kryetari i Komunes Ramiz Lladrovci-ne nuk e dimë akoma a ka me vazhdua procesi mësimor komuna jemi me së miri të përgatitur ,këtu janë edhe do operator te trafikut urban këta kanë aplikuar në fillim të vitit dhe e kanë marr orarin ,ne nuk mundemi me ndërruar tani për shkak të pandemisë e kanë për obligim me pas një numër me të vogël të udhëtareve nëpër autobusë por nëse ata kanë vullnet me ndërruar jemi ne dakord ,por është e pa mundshme me harmonizoj lëvizjen e trafikut urban me mësimin që e mbajnë nxënësit ne dy shkollat e mesme sigurisht

Fjalën e merr Drejtori i Drejtorisë se Arsimit Muhamet Gjoka-sa i përket transportit po flas për pjesën si Drejtori e Arsimit me te cilën e kemi diskutuar neve bashkë me komisionin që është edhe menaxherin e kontratës operatorit publik transportit publik kemi pasur takim dhe kemi kërkuar koordinim apo nëse është e mundshme sepse operatori publik janë te obliguar edhe me ligj qe ti përmbahen protokolleve shëndetësore, mirëpo ne kemi kërkuar që të përshtatet ne maksimum orari dhe të evitohet kjo që përmendet që mund te jetë me prit dy ore nxënësit për shkak të ndërrimeve dhe për shkak te orarit te shkurtuar dhe që ndoshta ka qenë e pamundshme për të gjithë që te përshtatet mirëpo e kemi paraparë me diskutuar këtë çështje si Drejtori e Arsimit dhe kemi kërkuar, kemi pasur takim edhe më Operatorin dhe kemi që kjo me koordinim me shkollat të përshtatët ne maksimum që te mos ketë pritje të tilla dhe kjo është sa i përket transportit publik ndërsa për transportin privat kemi kërkuar nga drejtoret, edhe pse ata nuk i kemi ne menaxhim direkt kemi kërkuar që te raportojnë kur i sjellin numrin fëmijëve nëse oshte jashtë udhëzimeve te raportojnë tek ne se bashku me inspektoratin dhe policinë dhe na duhet te marrim masa, kjo ka qenë sa i për këtë transportit neve si Drejtori e Arsimit kemi sigurim bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike sa i për këtë përshtatjes se orarit.

Beqir Kiqina - Sa i përket Komunës se Drenasit përgatitjeve për fillimin e vitit te ri shkollorë unë këtu kisha dashtë te falënderojë Drejtorin po edhe Kryetarin për qasjen e duhur në këtë

aspekt dhe bashkëpunimin nder institucional ,është e vërtet që unë kam qenë në teren nëpër shkollat e Komunës se Drenasit në bashkëpunim me drejtorinë unë jam i kënaqur sa i përket kësaj çështje ,desha të i them Kryetarit se pavarësisht pozitive tona dhe kundërshtimeve tona politike që kanë qenë dhe munden me qenë asnjë here nuk kam me anashkaluar komunën tone dhe jam mundu qe me paraqit sa me mirë, unë jam sot në këtë pozite dhe nesër me ndryshuar rrethanat politike mundem mos me qene në këtë pozite dhe nuk ka asnjë rëndësi ,rëndësi ka interesi i përgjithshëm .

Vehbi Berisha –desha me ngrit një çështje që lidhet me dy drejtorit atë të Arsimit dhe Shëndetësisë një çështje që lidhet me hendikosit ata kanë probleme të mëdha me buxhet ata ngec të shpija për shkak se hendikosi nuk ka buxhet për me bërë transportin e nxënësve a ka mundësi një mundësi bile me i shtinë në kategorinë e mallra dhe shërbimeve bile me u a hiq transportin në bazë të asaj çfarë që kesh prezent ata thane që nëse vazhdon kështu kemi me pas problem edhe me ekzistuar si qendër mendoje që nëse mbyllet hendikosi në Drenas askush prej neve nuk do të ndihet mirë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-ne çka mundemi me i ndihmuar hendikosit por edhe familjeve me nevojë kemi me i ndihmuar sa herë që kemi mundësi me gjera të ndryshme ,unë nuk mund me marr përgjithësi me ndihmuar ata me buxhet ku nuk ma lejon ligji unë i kam taku vet kam fol vet ju po mermi përgjithësi ju dilni zot unë nuk e shkeli ligjin aty ku nuk kam drejte. Florentina Elezi –vetëm deshta me e pyet a keni pas mjete financiare si drejtori me i furnizuar shkollat me maska dhe a janë shumë përdorimesh më

Fjalën e merr Drejtori i Drejtorisë se Arsimit Muhamet Gjoka- po kemi pas mjete financiare edhe për maska edhe me mjete dezinfektuese higjienikë ,furnizimin e kemi bërë prej donatoreve buxhetit komunal ,nivelit qendror ministrisë dhe kemi me i përcjell në vazhdimësi në bazë të nevojave të shkollave , sasi rezerve e kanë të gjitha shkollat mirëpo e kemi planifikuar me furnizuar prape dhe kemi paraparë një buxhet shtesë rreth 10.000€ që deri në fund të vitit me i pajisë të gjitha shkollat me maska dhe pajisje të tjera .

Nëse me lejohet ne lidhje me çështjen që e ngriti zoti Berisha mund të i them se Drejtoria e Arsimit i kemi kushtuar vëmendje te nevojshme kësaj kategorie ,dhe jemi komuna e vetme që e kemi nxjerr një udhëzues për mësimdhënës në mënyre që kjo kategori mos të mbetet e pa përfshire në procesin mësimor si online ashtu edhe nëpër shkolla dhe brenda mundësive ligjore të përkrahim këtë kategori .

Petrit Gashi e falënderoi drejtorin për bashkëpunim gjatë kësaj kohe vërtet jemi në kohë pandemie dhe të gjithë duhet të kontribuojmë ,për të lehtësuar mënyrën e mësimit online edhe pse e dimë efektivitetin e mësimit në këtë kohë që po e bëjmë ,shumicën e gjerave që kam pas me i banë i kemi diskutuar bashkërisht por prape e kam një pyetje për një fëmijë me aftësi të kufizuara që është në shkollën e Arllatit ,a është bërë diçka për Arllat a ka mbet ashtu gjendja e njëjtë ?

Fjalën e merr Drejtori i Drejtorisë se Arsimit Muhamet Gjoka- vetëm për informatën juaj ,neve kemi angazhuar edhe asistent mbështetës dhe është duke u zhvillu procedura që edhe Arllati të mbulohet më mësimdhënës të nevojshëm që te merret me këtë kategori ,është dashur që një mësimdhënës të angazhojmë në disa shkolla por edhe asistent për fëmijë me nevoja të veçanta edhe mësimdhënës mbështetës .

Kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj-hapi për diskutim pikën 13.Të ndryshme.

Sokol Bylykbashi –deshta të flas për disa shqetësime ankesa në Llapushnik ndërtimit të një rrugës në lagjen Gashi mua me kanë thënë se është bërë ndërtimi në një rruge private që ka shpija me pak ndërsa një rrugë publike ose e pa rëndësishme është injoruar nëse është kështu

është gabim dhe nuk kemi të bëjmë me interesin e qytetarëve ,ju e dini që për me shtrua rrugë private janë disa procedura që duhet me i përfunduar edhe disa letra me i rehatuar mua dikush me thirri para seance dhe me tha mos me fol për shkak që është rrugë e imja po unë fola por mbi të gjitha janë ankesat

Kryetari i Komunes Ramiz Lladrovci- vetëm desha të them që Llapushniku është vendi që kemi punuar me se shumti në infrastrukture.

Petrit Gashi – para është dezinformat nëse thotë Sokoli se kam ditë rruga është e gjatë 245 m prej tyre vetëm 18 metra ne fakt janë ë pronë private mirëpo ajo rrugë është pronë publike mundeni me gjet edhe në portal ,ky personi në fjalë meriton një falënderim se ka leshu pronën private në mënyrë qe rruga publike me qenë e qasshme ,rruga për të cilën jemi duke fol i ka dy persona me aftësi të kufizuara dhe e falënderoi drejtorin përkatëse që kur ka pas reshje të bores kanë ardhë dhe ia kanë liruar rrugën

Sokol Bylykbashi unë fillimisht e ngrita një çështjeje si ankesë dhe tërë ajo çfarë fola ke një pyetje ndërsa ti me akuzon mua se nuk kam informacione ,a e kupton ti mungesën e informacioneve te bollshme dhe pyetjes .

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, kryesuesi i Kuvendit Komunal konsideroi të mbyllur seancën.

Mbledhja përfundoj në orës: 13: 00 .

Drenas 23.09.2020

Procesmbajtëse:



Fakete Hoti





REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Zyra e Kuvendit



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me datë 23. 10 .2020, si vijon:

-Pasi kryesuesi i mbledhjes Gani Podrimqaku përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e K.P.F-ca se kemi një pika shtesë në rendin e ditës : Propozim Vendim për shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të pronave të paluajtshme ish shoqërore të OP-Drenicës,të cilat janë nënë menaxhimin e AKP-së, në zonën Kadastrale Korroticë të Epërme.

Të gjithë anëtarët e K.P.F-ca u pajtuan që të futen edhe kjo pika shtesë në rendin e ditës, dhe u aprovua në mënyrë unanime nga të gjithë anëtarët rendi i ditës me:

Votuan 05 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të datës. 16.09.2020.

Votuan 05 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00

2. Raporti Financiar i Zhvillimit Të Buxhetit Janar Shtator 2020.

Rekomandohet për mbledhje të Kuvendit.

3. Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit 12-400-40369,të datës. 23.09.2020,të Kuvendit të Komunës së Drenasit.

Votuan 03 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 2

4. Propozim Vendim shfuqizimin e Vendimit 12-400-40360, të dt. 23.09.2020,të Kuvendit të Komunës së Drenasit.

Votuan 03 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 2

5. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të pronave të paluajtshme (njësive të ndërtesave –banesave) ,në parcelën nr. 743-1,në zonën kadastrave në Drenas (Gllogoc).

Votuan 03 Për, Kundër: 2, dhe Abstenim: 0

6. Propozim Vendim për këmbimin e pronave të paluajtshme (ndjesive të ndërtesave-banesave) në parcelën nr. 743-1,në zonën kadastrave në Drenas (Gllogoc).

Votuan 03 Për, Kundër: 2, dhe Abstenim: 0

7. Propozim Vendim për shpronësimin e pronave të paluajtshme (njësive të ndërtesave –banesave) ,në parcelën nr. 743-1,në zonën kadastrave në Drenas (Gllogoc).

Votuan 03 Për, Kundër: 2, dhe Abstenim: 0

8. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të pronave të paluajtshme të hekurudhave të Kosovës (Shoqëri Aksionare) për parcelat nr. 953-1,961-0,956-0, të cilat ndodhen në zonën kadastrale Drenas (Gllogoc).

Votuan 03 Për, Kundër: 2, dhe Abstenim: 0

9. Propozim Vendim për transfero të mjeteve nga projekti rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbëruese dhe rregullimi i sheshit të qytetit në projektin mirëmbajtja e kanalizimeve fekale, atmosferike dhe gropave septike.

Votuan 05 Për, Kundër:00, dhe Abstenim: 00

10. Propozim Vendim për shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të pronave të paluajtshme ish shoqërore të OP-Drenicës, të cilat janë nënë menaxhimin e AKP-së, në zonën Kadastrale Korroticë e Epërme.

Votuan 03 Për, Kundër: 2, dhe Abstenim: 0


11. Të ndryshme.

Pasi spati diskutime mbledhja përfundoi në ora 11: 36.




Kryetari i Kuvendit

Minot Halila



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
ZYRA E KRYETARIT



REPUBLIKA E KOSOVES KOMUNA GLLLOGOC GLLLOGOC MUNICIPALITY			
Prantuar	13/10		2020
Nj. Org.	Numër	Shifra	Vlera
01-	400-	43759	

RAPORTI FINANCIAR
I ZHVILLIMIT TË BUXHETIT JANAR - SHTATOR 2020

TETOR 2020

Baza për Raportim

Në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP-së) përkatësisht neni 45.4, kryetari i komunës duhet të përgatit dhe t'i dorëzojë kuvendit komunal raporte periodike të cilat mbulojnë vitin fiskal deri në fund të vitit i cili sa po ka përfunduar. Këto raporte duhet t'i dorëzohën kuvendit komunal dhe një kopje ministrit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të çdo periode, dhe më pasë duhet të publikohën në faqën e internetit të komunës.

Qëllimi i këtij raporti është që të njoftoi Bordin e Drejtorve, Komitetin për Politikë dhe Financa, Kuvendin Komunal, të gjitha mediet (elektronike dhe të shkruara) si dhe qytetarët për realizimin e buxhetit komunal për periudhën raportuese janar-shtator 2020.

Buxheti komunal për periudhën janar-shtator 2020 nënkupton Ligjin .07/L-001 dhe 07/L-014 I rishikuar të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Deri sa buxheti paraqet qëllim-et e performancës, raporti paraqet masën deri në të cilën qëllimet e performancës janë arritë, duke përfshi vlerësimin kuantitativ dhe kualit-ativ të rezultateve. Ky raport gjithashtu paraqetë edhe krahasime me periudhën e njejtë të një viti më parë. Në këtë raport paraqitët mënyra e realizimit të buxhetit për nga karakteri ekonomik në pesë kategori kryesore ekonomike të shpënzimit; ndërsa për nga karakteri funksional në njëzetë (20) programe -nënprograme buxhetore.

Të dhënat e raportit për shpenzimet operative (Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime, Shpenzime të Shërbimeve Komunale dhe Subvencio) dhe Shpenzime të Investimeve Kapitale, janë në harmoni me Departamentin e Thesarit pranë Ministrisë për Financa, ndërsa të dhënat për numrin e punëtorve dhe shumat për shpenzimet e Pagave dhe Mëditjeve me Shërbimin e Përlogaritjës së pagave Ministrin e Administratës Publike.

Përgatitja e raportit është bërë në pajtim me Ligjin e Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësit 03/L-048, të ndryshuar me Ligjin 04/L-221, dhe Standardet Ndërkombtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) bazuar në para të gatshme-raportimi financiar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Në raport vërehet se programet - nënprogramet rëndësi të veçant i kanë dhën shpenzimit të mjeteve të financuara nga Grantet Qeveritare si burim kryesor i të hyrave, pasi të hyrat nga burimet vetanake janë në disponim për shpenzim pa ndoni shkurtrim eventual nga Qeveria. Zyra e Kryetarit gjatë përgatitjes së këtij raporti s' bashku me Drejtoratin për Buxhet dhe Financa është munduar me përkushtimin më të madh që me detaje dhe saktësi të paraqes realizimin-zhvillimin e buxhetit komunal për periudhën raportuese, gjegjësisht janar-shtator/2020. Valuta raportuese është Euro (€).

Ne mirëpresim çdo koment që do të kontribonte pozitivisht në përmirësimin e raporteve të ardhshme.
Tabela Nr.1 Buxheti Komunal sipas Ligjit Nr.07/L-001 dhe 07/L-014 për Buxhetin e Republikës së Kosovës të rishikuar për vitin 2020

Tab.nr.1

Përshkrimi	Buxheti	Pagat	Mallra e sherb.	Shp.Kom.	Sub.trans	Invest. Kapitale	Rezerva	Nr.punt
Z.Kryetarit	229,439.00	140,339.00	44,518.00	-	6,000.00		38,582.00	19
Adm.person	618,858.00	221,372.00	138,065.00	1,549.00	1,167.00	227,240.00	29,465.00	42
Inspektorati	108,264.00	67,478.00	37,515.00	-	-		3,271.00	11
Z.Kuvendit	149,557.00	108,920.00	24,140.00	-	-		16,497.00	-
Buxhet dhe finan.	120,906.00	97,032.00	18,340.00	-	-		5,534.00	16
Shërb Pub. Em.	694,357.00	182,357.00	274,365.00	55,495.00	10,000.00	172,140.00	-	25
Infrastruktur Publike	2,907,712.00	47,423.00	23,460.00	-	-	2,830,517.00	6,312.00	8
Z.K.Kthim	10,106.00	7,963.00	1,083.00	-	-		1,060.00	1
Bujqësia	143,788.00	70,530.00	11,181.00	-	58,355.00		3,722.00	13
Planif.dhe Zhvill.Ekon.	80,268.00	42,906.00	24,348.00	-	-		13,014.00	8
Gjeodezi dhe Kad.	305,277.00	77,810.00	5,110.00	-	-	212,000.00	10,357.00	13
Urbanizmi	93,566.00	47,199.00	18,235.00	-	-	21,850.00	6,282.00	8
Administrata Sh.	360,824.00	35,778.00	60,338.00	-	259,200.00		5,508.00	5
Kujd.Prim.Shënd	2,057,015.00	1,336,255.00	325,360.00	45,288.00	-	345,344.00	4,768.00	181
Shërb Sociale	111,720.00	77,713.00	16,713.00	5,951.00	-		11,343.00	14
Kultura dhe sporti	411,720.00	66,081.00	49,449.00	-	77,393.00	210,045.00	8,752.00	13
Adm. Arsrim	933,296.00	75,833.00	315,266.00	-	84,478.00	441,201.00	16,518.00	12
Ars.Parafillor	185,770.00	118,025.00	46,482.00	6,120.00	-		15,143.00	22
Ars. Fillor	5,501,306.00	4,468,470.00	299,835.00	61,312.00	-	24,069.00	647,620.00	739
Ars. I Mesem	1,506,709.00	1,259,517.00	75,506.00	19,626.00	-		152,060.00	175
Totali	16,530,458.00	8,549,001.00	1,809,309.00	195,341.00	496,593.00	4,484,406.00	995,808.00	1325

